VENDIM
Nr. 272, datë 10.12.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË 8.11.2017, "MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË 'OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR' 'ALBGAZ' SH.A." , I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; tëneneve 53, pika 2; dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 634/5 prot., datë 5.12.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, 'Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror' 'Albgaz' sh.a.", i ndryshuar;

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 59, datë 2.4.2024, ka vendosur të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, duke i lënë kushtin shoqërisë "Albgaz" sh.a. të depozitojë në ERE, brenda datës 31.12.2024, realizimin e ndryshimeve në nenet 11 dhe 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- ERE njoftoi shoqërinë dhe palët e interesit për vendimin nr. 59/2024 me shkresën nr. 634/2 prot., më datë 11.4.2024, për shtyrjen e afatit për realizimin e ndryshimeve ligjore deri më datë 31.12.2024.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 634/4 prot., datë 20.11.2024, i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrjen e afatit për plotësimin e kushtit të certifikimit si "Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror". Shoqëria ka bërë me dije se vijon punën për zhvillimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, një proces ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka rol kyç si institucioni përgjegjës për politikat dhe mbikëqyrjen e projekteve të zhvillimit. Gjithashtu, shoqëria "Albgaz" sh.a. ka njoftuar se më 12 nëntor 2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompania shtetërore e naftës "SOCAR" kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për gazifikimin e qytetit të Korçës, i cili hap rrugën për fillimin e projektit të detajuar inxhinierik pas përfundimit të studimit të fizibilitetit.

- Shoqëria ka bërë me dije se, për shkaqe jashtë vullnetit të saj, transferimi i kompetencave dhe depozitimi në ERE i dokumentacionit për ndryshimet në nenet 11 dhe 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe kalimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) janë jashtë përgjegjësisë së saj. Shoqëria mbetet në pritje të një përgjigjeje përfundimtare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për përmbushjen e këtij kushti.

- Duke u bazuar në sa më sipër dhe informacionin e bërë të ditur nga shoqëria, kushti mbetet ende i paplotësuar. Në këto rrethana, vlerësohet e arsyeshme të merret në konsideratë kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e afatit për përmbushjen e këtij kushti deri më datë 31.12.2025, sipas sqarimeve të paraqitura prej saj.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 5.2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, bëhet si vijon:

"5.2 Brenda datës 31.12.2025 shoqëria "Albgaz" sh.a. duhet të depozitojë në ERE realizimin e ndryshimeve në nenin 11 dhe nenin 46, pika 10, të ligjit "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Financave.".

2. Ky vendim i shtrin efektet menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti